



DRJETORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

AKADEMIA E SIGURISË

KOLEGJI PROFESIONAL I FORMIMIT POLICOR

**PROGRAMI I STUDIMEVE
PËR SHKOLLIMIN BAZË POLICOR
“PATRULLË E PËRGJITHSHME”**

Viti Akademik 2022 -2023



Vendosur
AKDEMIJA E SIGURISË
KOLEGJI PROFESIONAL I FORMIMIT POLICOR

nr. 06 Prot.

Tiranë më 09.11.2022



MIRATOHET

REKTORI

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO



**PROGRAMI I STUDIMEVE PËR SHKOLLIMIN BAZË
POLICOR "PATRULLË E PËRGJITHSHME"**

DREJTORI

Drejtues Mihat TOLA

Mihat Tola

Tiranë, 2022

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT TË STUDIMEVE

PJESA I-rë

Programi i studimeve.

Struktura, objektivat dhe profili i certifikatës.

1. Përshkrim përmbledhës;
2. Përgjegjësitë dhe referencat ligjore;
3. Konsultimi me grupet e interesit;
4. Parimet dhe kërkesat e programit;
5. Përqasja e programit të studimit me misionin e Akademisë;
6. Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme;
7. Struktura dhe karakteristikat e programit të studimeve;
8. Veprimtaritë formuese;
9. Disa karakteristika;
10. Ndarja e krediteve sipas kategorisë së lëndëve;
11. Kompetencat që fitohen nga realizimi i objektivave;
12. Programi i formimit të përgjithshëm;
13. Lëndët e formimit të përgjithshëm;
14. Programi i formimit profesional;
15. Lëndët e formimit profesional;
16. Praktika profesionale;
17. Profili i certifikatës.

PJESA II-të

Plani mësimor i studimeve për Kolegjin Profesional i Formimit Policor

1. Hyrje;
2. Detyra themelore e planit mësimor;
3. Emërtimi i programit të studimit;
4. Kohëzgjatja dhe struktura e studimeve;
5. Objektivat formuese të planit mësimor;
6. Proçedurat, burimet dhe referencat e planit mësimor;
7. Veprimtaritë formuese që përbëjnë planin mësimor;
8. Struktura e planit mësimor, elementet përbërës të tij;
9. Lista e disiplinave të planit mësimor;
10. Veprimtaritë formuese të planit, sipas gruplëndëve dhe moduleve;
11. Lëndët dhe modulet e formimit të përgjithshëm;
12. Lëndët dhe modulet e formimit profesional policor;
13. Plani mësimor për simestirin dhe praktika në terren;
14. Vështrim analitik mbi planin;
15. Standardet e personelit akademik të programit;

“PROGRAMI I STUDIMEVE I KOLEGJIT PROFESIONAL I FORMIMIT POLICOR”

PJESA I-rë

ARGUMENTIMI I ÇELJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT PËR “PATRULLË TË PËRGJITHSHME”

Struktura, Objektivat dhe profili i certifikatës

1. Përshkrim përmbledhës.

- Lloji i studimeve: Studime të larta profesionale;
- Emërtimi akademik: Program studimi për: “Patrullë e Përgjithshme” në Policinë e Shtetit;
- Kohëzgjatja e studimeve: 1(një) vit;
- Forma e studimeve: Me kohë të plotë;
- Numri i krediteve ECTS: 60 kredite ECTS;
- Profili profesional i pritshëm: Punonjës policie “Patrullë e Përgjithshme”
- Objektivi i plan-programit: *“Të përgatisë punonjës policie të rolit bazë, me profil “Patrullë e Përgjithshme”, të aftë për të vepruar në shërbimet policore për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike;*
- Struktura e programit: Ndarja e 60 krediteve ECTS, sipas kategorizimit të lëndëve përafërsisht është:
 - formimi i përgjithshëm, 14 kredite;
 - formimi profesional, 36 kredite;
 - veprimtari praktike/profesionale 10 kredite;
- Kushtet e pranimit: Pranimi në Programin studimeve për sigurinë:
 - të ketë përfunduar maturën shtetërore, ose të zotërojë një diplomë të arsimit të lartë.
 - të ketë marrë pjesë dhe të jetë shpallur fitues në procesin e konkurrimit për pranim në Kolegj.
- Njësia akademike zbatuese: Kolegji Profesional i Formimit Policor
- Institucioni i Arsimit të Lartë: Akademia e Sigurisë, Sauk - Tiranë

2. Referencat ligjore dhe përgjegjësitë institucionale

Programi i studimeve të Kolegjit Profesional i Formimit Policor, në profilin “Patrullë e Përgjithshme”, që paraqitet për shqyrtim e miratim, është hartuar në ushtrim të përgjegjësiave e të drejtave që burojnë nga legjislacioni për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe nga ligji “për Policinë e Shtetit”, në zbatim të pëlqimeve e urdhërimeve të Statutit të Akademisë së Sigurisë.

Akademia e Sigurisë është institucioni më përfaqësues i arsimit të lartë policor dhe ligjërish përcaktohet si institucioni arsimor përgjegjës për përgatitjen dhe formimin profesional të punonjësve të policisë të nivelit zbatues për rendin dhe sigurinë publike. Ajo është vazhduese e denjë e shkollimit policor të këtij niveli në vite dhe bart e përçon vlerat më të spikatura të atdhetarisë, profesionalizmit dhe akademizmit në fushën e rendit, sigurisë dhe luftës ndaj krimit. Në këto vite të zhvillimit të kësaj shkolle evidentohet se, pavarësisht formës së organizimit shtetëror, apo kushteve sociale, politike e ekonomike në të cilat kalonte vendi, arsimit dhe kualifikimi policor është vlerësuar si pjesë integrale e

Arsimit të Lartë. Ai ka qenë në një proces të pandërprerë zhvillimi, për edukimin e brezave të aftë të profesionistëve, për zgjidhjen në kohë të nevojave dhe kërkesave për rend, siguri e luftë ndaj krimit. Në përcjelljen e problematikave të vështira të rendit, të sigurisë shtetërore e të individit dhe luftës me dukuritë e reja kriminale të tranzicionit tonë të vështirë, kanë rolin dhe kontributin e tyre të pamohueshëm masa e madhe e trupës së policisë të udhëhequr nga menaxherët e saj, të cilët janë edukuar profesionalisht në institucionet e arsimit bazë e atij të lartë policor.

Akademia e Sigurisë është i vetmi institucion përgjegjës për pranimin, formimin, përgatitjen dhe kualifikimin e punonjësve të policisë të të gjithë roleve, për të qenë të aftë dhe të përkushtuar për mbrojtjen e rendit e sigurisë publike dhe garantimin e zbatimit të ligjit, si dhe për zhvillimin e realizimin e kapaciteteve kërkimore shkencore në fushën e policimit demokratik.

Veprimtaria e Akademisë së Sigurisë sot mbështetet në legjislacionin arsimor, kryesisht në ligjin nr.80/2015, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore e normative të kësaj fushe, në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” (kreu VII, neni 37 e 38) dhe në VKM nr. 881, datë 28.10.2020, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë si i vetëm institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj”, në statutin dhe rregulloret e brendshme të saj. Në përputhje me statusin ligjor dhe misionin e Akademisë është hartuar edhe Programi i Studimeve i Kolegjit Profesional i Formimit Policor, në profilin “Patrullë e Përgjithshme”, (më poshtë do të quhet “Programi”) dhe “Plani Mësimor” për të përgatitur punonjës policie të rolit bazë, të profilit “Patrullë e Përgjithshme”, të aftë për të vepruar në shërbimet që organizon Policia e Shtetit.

Përveç referencave të mësipërme ligjore, hartimi i “Programit dhe Planit Mësimor” është mbështetur edhe në “Programin e zhvillimit strategjik të Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë”, në statutin dhe rregulloren e brendshme të saj, si dhe më diskutimet e propozimet e bëra nga stafi akademik i institucionit. Po ashtu, gjatë procesit të hartimit u mbajtën në konsideratë standardet e shkollave policore perëndimore për formimin e punonjësve të policisë të rolit bazë si dhe sipas përgjegjësive të nesërme në terren, duke i orientuar drejt profesionalizmit dhe aplikimit praktik të njohurive. Programi dhe plani mësimor e vënë theksin sa tek formimi shoqëror e juridik aq edhe tek zbatimi i procedurave ligjore dhe respektimi i lirive e të drejtave të njeriut, duke synuar që të integrojnë dhe vendosin ekuilibrat e nevojshëm akademikë midis disiplinave social-psikologjike, juridike e profesionale e të gjitha këto së bashku, t’i kombinojmë e adresojmë tek formimi solid i studentëve të Kolegjit Profesional.

3. Nevojat e çeljes së Programit.

Hapja e Programit të studimeve të Kolegjit Profesional të Formimit Policor, Kolegji i Policisë, diktohet nga faktorë të shumtë, në mes të cilëve veçohen “nevojat e tregut të punës”, konkretisht nevojat e policisë për shtimin, rinovimin dhe diversifikimin e kapaciteteve njerëzore të saj dhe përshtatjen me hapat e zhvillimit shoqëror e kulturor të vendit. Me konkretisht, çelja e këtij programi synon të zgjidhë këto nevoja të policisë:

- Për punonjës policie të rolit bazë për sigurinë publike, të aftë për të shërbyer në të gjitha llojet e shërbimeve dhe funksionet operuese, me kulturë e dije të nivelit universitar, me standarde të larta etike profesionale dhe njohës të mirë të ligjit, të misionit dhe përgjegjësive institucionale të policisë, por dhe me aftësi praktike.
- Për të eliminuar mangësitë dhe pasojat negative në fushën e edukimit policor dhe për përmirësimin e të nivelit profesional të punonjësve të policisë, sidomos të nivelit zbatues, nivel i cili jo gjithmonë

i përgjigjet nevojave të policimit dhe dinamikës së kriminalitetit, madje ndonjëherë është bërë pengesë në garantimin e rendit dhe sigurisë në parametra e standarde europiane.

- Njëpërmjet këtij programi synohet të zgjidhen nevojat e edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të forcave të policisë, për të rritur më tej shkallën e besimit të publikut tek Policia e Shtetit, e cila do të vijë me rritjen e mirësjelljes së punonjësve dhe patrullave të policisë në rrugë, apo në veprim, për të treguar faktin se kjo trupë ekziston për të mbrojtur qytetarin dhe shoqërinë nga keqbërësit, si forcë që garanton sigurinë e jetës dhe të pronës publike e private.
- Edhe më shumë ndjehet nevoja e këtij programi studimesh akademike, në kushtet e një vendi të NATO-s, që aspiron për të hyrë në BE, si dhe kërkesave gjithnjë në rritje të komunitetit për një polici profesionale e korrekte në shërbim të tyre. Është për këtë arsye që prej personelit të saj, kërkohet më shumë profesionalizëm, dinamizëm, pastërti morale, paanësi dhe bindje për të garantuar zbatimin e ligjit dhe parimet kushtetuese të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut.

4. Programi dhe grupet e interesit.

Departamentet e Kolegjit Profesional i Formimit Policor, krahas punës për riorganizimin e strukturave akademike, u përfshinë në një veprimtari të gjerë e intensive, për hartimin e planeve, programeve dhe kurrikulës universitare. Veçanërisht, i kushtuan vëmendje e kujdes të posaçëm kontakteve me grupet e interesit dhe faktorët institucionalë për marrjen e mendimeve, vlerësimeve, opinioneve dhe sugjerimeve të tyre, për disa nga çështjet më themelore, si: drejtimit ku duhet të thellohet veprimtaria e arsimit të lartë profesional për të evituar hendekun midis teorisë dhe praktikës dhe për të rritur integrimin mes tyre; në cilat aspekte mendohet se duhet përmirësuar profili i punonjësit të policisë të rolit bazë; nëse është e mjaftueshme përgatitja e tyre për t'u përballur me tendencat e zhvillimeve në fushën e rendit dhe krimin; përfaqësimi i punonjësit të policisë si njohës i çështjeve të sigurisë, të parandalimit dhe policimit në komunitet, etj. Programi mësimor përcjell kulturën qytetare, dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të ketë punonjësi i policisë i ditëve tona.

Ndër veprimtaritë konsultative për hartimin e programit për rendin dhe sigurinë publike, përmendim këto:

- konsulta me personelin mësimdhënës dhe administrativ të “Shkollës së Formimit Bazë” të policisë,
- bashkëbisedimi dhe shkëmbimi i mendimeve me specialistët e sektorit të zhvillimit dhe kurrikulave;
- organizimi i ballafaqimeve dhe konsultave me specialistët e Drejtorisë së Kufirit & Migracionit dhe Rendit e Sigurisë Publike, Hetimit të Krimin, administrimi e pasqyrimi i vërrejtjeve dhe sugjerimeve të tyre për programin;
- kontaktet dhe shkëmbimi i ideve dhe mendimeve me specialistët, pedagogët dhe drejtuesit e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit.
- takimi dhe bashkëbisedimet me specialistë të spikatur të fushave konkrete si, informatika, gjuhët e huaja, jurisprudenca etj.

5. Parimet dhe kërkesat e “Programit”.

Parimet dhe kërkesat themelore të programit burojnë nga kuadri ligjor e normativ i procesit akademik dhe nga misioni, detyrat e përgjegjësitë institucionale të Policisë së Shtetit. Është e rëndësishme të theksohet se i gjithë procesi i hartimit të Programit të studimit, i dokumenteve dhe akteve zyrtare që e shoqërojnë atë, mban parasysh dhe respekton parimet universale të zhvillimit të arsimit dhe kërkimit shkencor në institucionet akademike publike. Për rrjedhojë, si pjesë e Arsimit të Lartë Publik edhe programi i studimeve të Kolegjit Profesional i Formimit Policor:

- ofron mundësi të barabarta dhe shans të njëjtë, jo vetëm konkurrimi, por edhe shkollimi, pa përjashtuar askënd që plotëson kriteret;
- mundëson që programet të gjitha lëndëve dhe disiplinave të sigurojnë “integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor”;

- është me karakter gjithëpërfshirës dhe jo si e drejtë, atribut apo privilegj i njerëzve apo subjekteve të veçantë;
- siguron kushtet që studentët/kursantët e Kolegjit Profesional i Formimit Policor të mësohen nga staf akademik me performancë të lartë në mësimdhënie;
- ofron kushte e mundësi që stafi dhe studentët/kursantët e Kolegjit Profesional i Formimit Policor të gëzojnë liri të plota akademike dhe pavarësi organizative në aktivitetin mësimdhënës dhe promovimin akademik.

Rëndësia e njohjes dhe zbatimit të tyre qëndron në faktin se, shmangiet nga parimësia në procesin e hartimit të dokumenteve dhe jetësimin praktik të tyre, rrezikojnë arritjen e objektivave dhe shkaktojnë kosto për gjithë procesin akademik.

6. Përfaqja e programit me misionin e Akademisë së Sigurisë.

Studimet në profilin “Patrullë e Përgjithshme”, organizohen dhe realizohen në Akademinë e Sigurisë, nën përgjegjësinë e Kolegjit Profesional i Formimit Policor dhe departamenteve e strukturave përbërëse të tij.

Akademia e Sigurisë ka për mision: *“Formimin bazë, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, të nivelit operues, administrativ dhe menaxherial, në të tre ciklet e studimeve universitare; zhvillimin e kërkimeve e studimeve në fushën e policimit e të sigurisë, si dhe kualifikimin e specializimin e punonjësve të agjencive të tjera të policimit dhe punonjësve të personave fizikë e juridike të fushës së rendit e sigurisë publike”.*

Ndërkohë, është evidente përfaqja e misionit me qëllimin dhe objektivin themelor të programit, që është: *“Të përgatitë punonjës policie të rolit bazë, me profil “Patrullë e Përgjithshme”, të aftë për të vepruar në shërbimet policore për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, me dije të nivelit universitar (psikologjik, sociale, juridike e profesional) dhe shprehje aplikative në funksion të realizimit të misionit, përgjegjësi dhe nevojave të Policisë së Shtetit, me standarde të larta etike e profesionale dhe me aftësi praktike për zotërimin e taktikave dhe teknikave bashkëkohore në fushën e parandalimit e luftës kundër krimit”.*

Ky program studimesh mbështetet në disa dokumente themelore, ndër të cilat veçohen, plani mësimor dhe “syllabus”-et e lëndëve, programet mësimore të disiplinave përbërëse dhe rregullorja e programit të studimit të Kolegjit Profesional i Formimit Policor. Nëpërmjet tyre synohet zhvillimi dhe promovimi i shprehjeve të përshkruara në terma konkrete të ngarkesës akademike, të rezultateve të procesit akademik (mësimdhënies e mësimnxënies), kompetencave që do të përftoheshin dhe profilit të prishëm të punonjësit të policisë të rolit bazë për rendin dhe sigurinë publike.

7. Objektivat e programit dhe rezultatet e pritshme.

Mbështetur në nevojat që ka policia për kualitete të spikatura profesionale dhe detyra, për goditjen e formave dhe metodave të veprimtarisë kriminale, objektivat më specifike e të veçantë që synohet të realizohen me zhvillimin e këtij programi janë:

- Plotësimi i nevojave që ka Policia e Shtetit për resurse të reja dhe të afta, profesionalisht dhe me nivel të lartë kulturor të përputhur me zhvillimin social e ekonomik të vendit, të cilët do të mbështesin zhvillimin më tej të interesave dhe vlerave kombëtare.
- Rritja e kapaciteteve të formimit policor, duke respektuar angazhimet, parimet dhe përvojat e shkollës shqiptare të policisë dhe shkollave më të mira perëndimore, në kuadër të angazhimit dhe integritetit në BE.

- Realizimi i programit të studimeve universitare bashkëkohore me punonjësit e policisë të rolit bazë, krahas vlerësimit të përvojave të deritanishme, marrin në konsideratë kërkesat në rritje të komunitetit, për një polici profesionale, të edukuar dhe sa më pranë tij.
- Gjatë një viti, programi, synon t'u ofrojë studentëve/kursantëve njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit sociologjik, psikologjik, juridik, synon të ofrojë njohuri të karakterit profesional të bazuara në lëndë e formimit profesional, mbi shërbimet policore dhe teknika të sigurisë publike që aplikohen, taktika e teknika veprimi efektive, veprimtari formuese si gjuhë e huaj e informatikë, të cilat përkojnë me profilin e detyrave që do të kryejnë dhe me kategorinë e certifikatës personale për siguri publike si dhe duke vendosur objektiva specifike për përgatitjen e punonjësve të rolit bazë të rendit, sigurisë e luftës ndaj krimit, të aftë për të vepruar në këtë fushë e në çdo situatë.
- Është pjesë e objektivave të këtij programi dhe e tërë kurrikulës t'u ofrojë studentëve/ kursantëve njohuritë e nevojshme për të zgjidhur problematikat profesionale me të cilat do të përballen gjatë ushtrimit të detyrave dhe profesionit të tyre, duke përmbushur kështu në kohë nevojat që do t'u lindin punonjësve të policisë për kualifikim të mëtejshëm dhe ecuri në karrierë, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Me shlyerjen e detyrimeve të parashikuara, në përfundim të këtij programi studentët/kursantët do të zotërojnë kapacitetet, konceptet e nevojshme për të kuptuar dhe trajtuar profesionalisht tematika e situata të fushës së rendit e të sigurisë, duke siguruar në këtë mënyrë asetet e nevojshme akademike për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit.

8. Struktura dhe karakteristikat e programit të studimeve të Kolegjit Profesional i Formimit Policor.

- a) **Struktura.** Programi i studimeve në profilin “Patrullë e Përgjithshme, është program studimesh universitare i organizuar në module e lëndë dhe i vlerësuar në kredite, sipas “Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve”(ECTS). Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program rishikohen nga departamentet e Kolegjit, mandej përcillen për miratim Këshillin e Kolegjit dhe më pas Senat.
- b) **Veprimtaritë formuese.** Ndër veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit “Për rendin dhe sigurinë publike” në profilin “Patrullë e Përgjithshme”, veçohen:
 - mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë);
 - studimi individual (hulumtimi, kërkimi, studimi, punim relacionesh, detyrat përgatitjet e provimeve, etj);
 - veprimtari të tjera, si praktika profesionale dhe vendosja në rol pranë strukturave vendore të policisë.


Përcaktimi dhe ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë përcaktohet nga personeli akademik përgjegjës për disiplinën, në bazë të krediteve që i janë caktuar asaj disipline.

- c) **Disa karakteristika.** Programi i studimeve ka karakteristika dalluese në raport me të tjerët, si:
 - ai është program me kohë të plotë;
 - procesi mësimor është i organizuar në një vit akademik;
 - në fund të tij, studenti/ kursanti i Kolegjit Profesional i Formimit Policor mund të fitojë 60 kredite;
 - viti akademik zgjat 35 javë mësimore, i ndarë në dy semestra;
 - semestri akademik zgjat 24 javë mësimore;
 - java mësimore është pesë ditë (e Hënë - e Premte);

- çdo ditë mund të zhvillohen deri në 7 orë mësimi;
- studenti zhvillon jo më shumë se 35 orë mësimore/javë, në auditor;
- semestri i praktikës në teren që zgjat 11 javë;
- koha e fillimit, koha e mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e dimrit dhe të festave zyrtare, etj, përcaktohen në kalendarin akademik, i cili miratohet çdo vit.

- d) **Ndarja e krediteve sipas kategorisë së lëndëve.** Në tërësinë e krediteve që do të marrë studenti/kursanti që ndjek këtë program studimi, duhet të marrë së paku:
- 14 kredite ECTS, për kategorinë e disiplinave të formimit të përgjithshëm.
 - 36 kredite ECTS, për disiplinat e formimit profesional të programit.
 - 10 kredite ECTS në kategorinë e veprimtarive formuese (praktike në teren).

Numri i përgjithshëm i lëndëve ose grup-lëndëve të programit së bashku me praktikën mësimore janë 10 në 1 vit. Provimet organizohen sipas moduleve.



9. Kompetencat që fitohen nga realizimi i objektivave.

Nga zhvillimi i disiplinave dhe veprimtarive akademike që përshkruhen në programin e studimeve të Kolegjit Profesional i Formimit Policor do të mundësohet realizimi i objektivave të formimit tërësor të studentëve dhe do të fitohen dije, aftësi e shprehje profesionale që do të përbejnë profilin kulturor e profesional të studentit:

- Realizimi i dijeve të karakterit të formimit të përgjithshëm (bazë), ç'ka do të vijë nga zhvillimi i një grupi disiplinash dhe veprimtarive formuese nga fusha e psikologjisë, sociologjisë, lëndë të veçanta, etj. Realizimi i këtij objektiv do të rrisë kapacitetet e studentëve për analizë dhe sintezë, njohuritë themelore të përgjithshme dhe mbështetjen për njohuritë bazë të profesionit.
- Përfëtimi dhe përvetësimi i dijeve të karakterit të formimit të posaçëm ç'ka lidhet me përkatësinë dhe të veçantën që përcjell programin e studimit dhe që realizohen me anë të grupit të disiplinave dhe veprimtarive formuese ngushtësisht profesionale. Këto krijojnë aftësi për t'u përshtatur në situata të reja dhe për të zbatuar njohuritë në praktikë, për të punuar në mënyrë të pavarur, për të pasur iniciativë, frymë vetëprimimi e vullnet, për të synuar suksesin, etj.
- Marrja e njohurive dhe dijeve që lidhen e zgjerojnë formimin ndërdisiplinor me anë të veprimtarive dhe disiplinave të ngjashme, të afërta dhe integruese me disiplinat dhe veprimtaritë profesionale si, njohuri juridike, etj. Në këtë mënyrë shtohen aftësitë për gjykime kritike dhe arsyetime të drejta rreth veprimeve të kryera e vendimeve të marra, aftësi për të punuar në ekip, aftësi ndërpersonale, për të komunikuar me ekspertë të fushave të tjera, vlerësim të zgjidhjeve alternative dhe respektimit të mendimit ndryshe.
- Nëpërmjet disiplinave dhe veprimtarive formuese të fokusuar drejt përvetësimit të gjuhëve të huaja, njohurive informatike, etj, të përfëtohen aftësitë njohëse e prezantuese, ose të aftësive komunikuese që

lehtësojnë kryerjen e detyrave të përbashkëta edhe me partnerët e huaj. Kështu shtohen aftësitë e komunikimit me gojë e shkrim, njohjet për një gjuhë të huaj, aftësi për menaxhim e informatikë, vlerësim të larmisë shumë-kulturore, aftësi për të zgjidhur problemet, etj.

10. Profili i Diplomës (Çertifikatës).

Me shlyerjen e të gjitha detyrimeve dhe realizimit të 60 krediteve, pasi ka shlyer edhe detyrimet e provimit përfundimtar, dhe praktikën në terren studenti/kursanti shpallet se ka përfunduar me sukses programin e studimeve të Kolegjit Profesional i Formimit Policor, në profilin “Patrullë e Përgjithshme”, me kohë të plotë dhe pajiset me “Diplomë (Certifikatë)”.

Diploma (Certifikatë) e programit të studimeve, shoqërohet me suplementin përkatës, dokument ky që hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Në suplement përshkruhen në veçanti, natyra, niveli, përmbajtja, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfundimi me sukses i të gjitha detyrimeve akademike e administrative.

Përmbajtja dhe forma e Diplomës (Çertifikatë) si dhe përmbajtja dhe forma e suplementit janë të përcaktuara në statutin e Akademisë së Sigurisë, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit.

11. Programi i formimit të përgjithshëm.

Në tërësinë e planit mësimor, lëndët e formimit të përgjithshëm ose të formimit universitar, përbëjnë **5 disiplina** mësimore ose rreth **50% të sasisë së lëndëve** që përmban i gjithë plani mësimor dhe **23.33% të krediteve** të programit të studimeve.

Lëndët e këtij grupi zënë rreth **350 orë**, ose **22.58 % të totalit të orëve mësimore**. Më konkretisht, lista e lëndëve të këtij karakteri është:

Lëndët e “Formimit të përgjithshëm”:

1. Legjislacion Policor;
2. Njohuri juridike;
3. Njohuri mbi Sociologjinë/Psikologjinë/Komunikimin;
4. Gjuhë e huaj;
5. Informatikë;

Nëpërmjet disiplinave të veçanta mësimore, të këtij programi synohet që, studenti të përfitojë dije e njohuri të nivelit bashkëkohor të fushës së sociologjisë, psikologjisë, komunikimit, juridike, gjuhës së huaj, informatikës, etj, si dhe në fushën legjislative. Të gjitha këto për të mbikëqyrur e zbatuar më korrektesë ligjin, për sigurimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë ushtrimit të kompetencave për rendin e sigurinë publike dhe në veçanti zbatimin e detyrave procedurale me atributet e agjentit të policisë gjyqësore. Me mbarimin e studimeve të këtij programi, profili i punonjësit të ardhshëm të policisë të rolit bazë do të kompletohet e do të përbëhet nga:

- dijet mbi organizimin, misionin dhe detyrat institucionale të Policisë së Shtetit dhe sistemin bazë që rregullon veprimtarinë e saj;
- nivel i lartë kulturor e qytetar dhe njohuri të plota shoqërore, kushtetuese e juridike, për ushtrimin e kompetencave dhe attributeve policore;
- kuptime të drejta mbi punën e policisë dhe gjetjen e mënyrave adekuate të interpretimit të shërbimeve të saj, në aspektin psikologjik e sociologjik;
- formim juridiko-penal për kryerjen e detyrave në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;
- një sistem i qëndrueshëm vlerash morale dhe cilësish të personalitetit e të karakterit të tij të krijuara nga studenti në mënyrë progresive;
- aftësi të shtuara për të menaxhuar stresin, ekuilibrat psikologjikë, komunikimin me qytetarët;
- aftësi për të analizuar dukuritë dhe problemet e ndryshme psikosociale;

- aftësi profesionale për të punuar në grup dhe për të zbatuar procedurat e teknikave ligjore dhe profesionale sipas etikës policore;
- perceptime të drejta mbi botën, jetën e përditshme dhe profesionin, përmes njohurive teoriko-praktike me ndikim direkt ose indirekt në profesionin e tyre të ardhshëm.

12. Programi i “Formimit profesional”.

Lëndët e formimit karakterizues ose profesional, në Planin mësimor, përbëhen nga 4 disiplina mësimore ose **40% të numrit të përgjithshëm të lëndëve** që përmban ai dhe **60% të krediteve të programit të studimeve**. Ndërkohë që sasia e orëve të përcaktuara për lëndët profesionale është **900 orë, ose rreth 58.06 % e totalit të orëve mësimore**, të gjithë ciklit njëvjeçar të studimeve, e më konkretisht:

Lëndët e formimit profesional”:

1. Shërbimet policore;
2. Taktika e teknika veprimi;
3. Njohuri për armët/quitje;
4. Përgatitje fizike-vetëmbrojtje,

Qëllimi kryesor i këtij grupi lëndësh është që të përgatisë punonjësin e ardhshëm të policisë të rolit bazë me njohuri profesionale bashkëkohore dhe aftësi vepruese, të aftë për të kryer në të gjitha llojet shërbimeve që organizon Policia e Shtetit si dhe të fushës parandaluese, të mbikëqyrjes policore, me marrjen dhe evadimin informacionit policor si dhe për hetimin e krimeve dhe për zotërimin e teknikave dhe shprehive vetëmbrojtëse.

Me shlyerjen e provimeve të lëndëve dhe përfundimin e detyrimeve të këtij programi, studentët, do fitojnë njohuri e aftësi të plota:

- për ligjet që ngarkojnë me detyra, me të drejta dhe me attribute policinë dhe me koncepte e shprehi profesionale mbi policimin;
- për llojet e shërbimeve policore për sigurinë publike dhe teknikave të sigurisë që aplikon Policia e Shtetit për kontrollin e territorit , për garantimin e rendit e sigurisë publike, taktikat dhe teknikave që duhet të përdorë për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të veta,etj;
- mbi veprimet konkrete për të zgjidhur konfliktet dhe realizuar shërbime parandaluese, si dhe për masat e veprimet në raste ngjarjesh të veçanta;
- në fushën e hetimit të krimeve, synohet që studenti të zotërojë njohuri mbi ligjin penal e procedurial penal, mbi veprat penale që drejtohen kundër jetës dhe shëndetit, vjedhjes, falsifikimit, trafikëve e të narkotikëve.
- Njohuri mbi vendin e ngjarjes, ruajtjen e tij dhe të provave materiale si dhe hartimin raportit të ngjarjes.
- njohuri të plota në fushën e shërbimeve policore, për legjislacionin që rregullon veprimtarinë e tyre, për të drejtat dhe përgjegjësitë, për teknikave të ndërhyrjes, kontrollit, vetëmbrojtjes etj.;
- aftësitë e shprehite aplikative për realizimin e misionit dhe detyrave të shërbimit policor;
- aftësitë për ekzekutime të ligjshme me kompetencë e paanshmëri gjatë detyrës;
- dije profesionale për parandalimin dhe zbulimin e kriminalitetit dhe aftësi për ushtrimin me kompetencë të detyrave në rolin e agentit të policisë gjyqësore;
- njohës i teknikave bashkëkohore në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të ndryshme si drogës, qenieve njerëzore, terrorizmit, etj.;


13. Praktika profesionale në terren:

Praktika profesionale, në planin mësimor zë rreth **16.66% të krediteve të programit të studimeve**, ndërkohë që sasia e orëve të përcaktuara për praktikën profesionale është **300 orë, ose rreth 19.35 % e totalit të orëve mësimore**, të të gjithë ciklit njëvjeçar të studimeve.

Në programet e lëndëve si dhe në këtë plan mësimor, është parashikuar një periudhë kohore prej njëmbëdhjetë javësh për praktike profesionale. Në plankalendar, kjo është menduar të shtrihet në tre muajt e fundit të parë 6 - mujor. Synimi kryesor i programit të praktikës profesionale, është vënia në rol e studentëve në të gjitha shërbimet që kryen “Patrulla e Përgjithshme” në strukturat vendore të policisë, me qëllim aftësimin e tyre në veprimtarinë praktike.

Studentët e kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale. Në përfundimin e semestrit të parë, departamenti përkatës i njeh studentët me programin e praktikës dhe kohën e kryerjes së tij. Studenti që nuk realizon programin e praktikës shpallet jokalues (mbetës) si për të gjitha detyrimet e tjera të parashikuara në program.

Praktikat zhvillohen në strukturat vendore të policisë, në komisaritet dhe sektorët e drejtorive vendore, nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës. Studenti/kursanti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen praktikën. Gjatë kryerjes së praktikës, pedagogu që e drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me strukturën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës, pedagogu dhe strukturat e trajnimit në DVP që e drejton praktikën përgatit një raport për punën e kryer nga studenti kursanti, pasi ka marrë më parë edhe mendimin e strukturës vendore të policisë ku është kryer praktika profesionale.



PJESA e II-të

PLANI MËSIMOR (AKADEMIK) I STUDIMEVE/ KURSANTËVE I KOLEGJIT PROFESIONAL I FORMIMIT POLICOR

Hyrje.

Plani mësimor i Programit të Studimeve të Kolegjit Profesional i Formimit Policor, është një ndër dokumentet bazë të këtij programi. Ai përfshin tërësinë e veprimtarive formuese (leksioneve, seminareve, praktikave, etj.) që Kolegji ofron për kryerjen e studimeve dhe marrjen e diplomës së punonjësit të policisë të rolit bazë në profilin “Patrullë e Përgjithshme”.

Në këtë plan mësimor përfshihen: disiplinat e formimit bazë, disiplinat profesionale, disiplinat integruese, veprimtaritë formuese për njohjen e gjuhës së huaj, aftësitë informatike, praktikat mësimore, etj. Të gjitha këto disiplina e veprimtari janë të vlerësuara si tepër të nevojshme për plotësimin e procesit akademik formues të punonjësit të policisë të rolit bazë në profilin “Patrullë e Përgjithshme”.

Plani mësimor, duke përbërë një dokument kryesor me karakter të gjerë informativ, por edhe normativ e të detyrueshëm për zbatim pas miratimit, është produkt i një eksperience disavjeçare të Shkollës Bazë të Policisë, i një veprimtarie të gjerë studimore e konsultative me grupe të ndryshme interesi, me specialistë të policimit, si dhe me studiues të rendit, sigurisë, kriminologjisë, sociologjisë e jurisprudencës.

Si rrjedhojë, përveç sa më sipër dhe veprimtarisë së Grupit të Punës i krijuar, u përfitua një listë lëndësh mësimore, por edhe një evidencë prioritetesh e kërkesash që burojnë e lidhen me eksperiencat më të mira të shkollës sonë të policisë dhe me standardet e pritshmëritë e publikut për performancë më të lartë policore.

Lëndët e parashikuara për formimin e përgjithshëm e të posaçëm të punonjësve të policisë të rolit bazë në profilin “Patrullë e Përgjithshme” për detyrat që do kryejnë dhe përgjegjësitë që do të përmbushin, e bëjnë planin dhe gjithë procesin mësimor të orientuar drejt profesionalizmit dhe aplikimit praktik të shprehive dhe njohurive të fituara. Gjatë hartimit të listës së disiplinave mësimore u bë kujdes që formimi teorik të krijojë dhe mbështetet në ekuilibrat e nevojshëm midis disiplinave të formimit të përgjithshëm dhe atij profesional, duke i dhënë përparësi këtij të fundit. Po kështu janë pasur parasysh edhe raportet e drejta ndërmjet disiplinave social-psikologjike dhe atyre juridiko-administrative e profesionale dhe i gjithë programi të vendosë theksin e duhur sa te formimi shoqëror e juridik aq edhe të përvetësimi dhe zbatimi i procedurave ligjore dhe respektimi i parimeve të shtetit ligjor e të drejtave të njeriut.

Metodat kryesore të punës mësimore në Akademinë e Sigurisë, për rrjedhojë edhe mjetet me të cilat do të realizohen detyrat dhe objektivat formuese e kualifikuese të këtij plani, sipas përcaktimeve të statutit dhe të Rregullores së Programit të Studimeve të Kolegjit Profesional i Formimit Policor janë:

Leksionet,
Seminaret,
Ushtrimet në klasë,
Mësimet në laboratorë,
Praktikat mësimore,
Vvizitat dhe praktikat profesionale në strukturat e policisë,
Kontrollet me shkrim e me gojë,
Provimet e lëndëve, etj.

1. Qëllimi dhe detyrat themelore të “Planit mësimor”.

Qëllimi dhe detyrat themelore të planit mësimor njëvjeçar janë:

- a. të formojnë punonjës policie të rolit bazë, të profilit “Patrullë e Përgjithshme”, të aftë për të vepruar në të gjitha shërbimet që organizohen nga Policia e Shtetit;
- b. të formojnë punonjës të policisë të rolit bazë, të profilit “Patrullë e Përgjithshme”, me kulturë e dije të nivelit universitar, (psikologjik, social, juridik e profesional), me standarde të larta etike profesionale dhe njohës të mirë të ligjit, të misionit dhe përgjegjësive institucionale të policisë;
- c. të formojnë punonjës të policisë të rolit bazë, të profilit “Patrullë e Përgjithshme”, me aftësi praktike e shprehi aplikative në zotërimin e teknikave bashkëkohore të fushës së parandalimit e luftës kundër krimit dhe për trajtimin e situatave ku çënohet rendi dhe siguria publike.

2. Emërtimi i “Programit të studimit”.

Programi i studimit emërtohet “**Programi i studimit për “Patrullë e Përgjithshme”**”.

Këto studime organizohen dhe realizohen në Akademinë e Sigurisë, nën përgjegjësinë e Kolegjit Profesional i Formimit Policor dhe departamenteve në përbërje të tij, në përmbushje të detyrave të tyre për formimin e punonjësve të policisë të rolit bazë të profilit “Patrullë e Përgjithshme”.

Ndër synimet kryesore të programit të studimeve që do të zhvillohet për formimin e punonjësve të policisë të rolit bazë të profilit “Patrullë e Përgjithshme” janë:

- a). Ofrimi i njohurive të përgjithshme kulturore, juridike, sociologjike, psikologjike, etj. dhe
- b). Thellimi në njohuritë që përkojnë me profilin e diplomës si dhe
- c). Përmbushja e nevojave që ka policia për resurse të reja e të afta profesionalisht për të zgjidhur problematikat profesionale, me të cilat do të përballen gjatë ushtrimit të detyrave dhe për goditjen e formave e metodave të veprimtarisë kriminale.

3. Kohëzgjatja dhe struktura e studimeve.

- a. Studimet, janë studime universitare vetëm me kohë të plotë dhe realizohen me një kohëzgjatje normale në 1(një) vit akademik. Në fund të studimeve njëvjeçare studenti mund e duhet të fitojë 60 kredite ECTS.
- b. Procesi mësimor është i organizuar në një vit akademik, me dy semestra, Semestri parë me disa provime/quz-e në vit sipas programit, me një periudhë prej njëmbëdhjetë javësh praktike profesionale në semestrin e dytë.
- c. Viti akademik zgjat 35 javë mësimore, i ndarë në dy semestra; semestri akademik zgjat 24- javë mësimore; java mësimore është pesë ditë (e hënë - e premte); çdo ditë mund të zhvillohen deri në 5 orë mësimi; studenti zhvillon jo më shumë se 25 orë mësimore/javë, në auditor. Praktika në teren zgjat 11- javë.

Koha e fillimit të vitit mësimor, koha e mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e dimrit dhe të festave zyrtare, etj. përcaktohen në plan-kalendarin akademik, i cili del në fillim të vitit akademik.

4. Procedurat, burimet dhe referencat e “Planit mësimor”.

Si dokumente referuese apo burimore në të cilat u mbështetëm për hartimin e planit janë përcaktimet dhe referencat ligjore të Arsimit të Lartë (ligji dhe aktet nënligjore e normative) dhe objektivat e dokumentet e reformës së Institucioneve të Arsimit të Lartë që u ndërmor vitet e fundit, eksperiencat pozitive dhe përvojat më të mira të shkollimit tonë policor, standardet e shkollave policore analoge perëndimore, etj.

Nga veprimtaritë më kryesore të ndërmarra gjatë fazës së hartimit të plan-programit mësimor, lidhur me drejtimit ku duhet përqendrohet më mirë vëmendja e strukturave akademike të policisë, veçojmë:

- Konsultat me personelin mësimdhënës e administrativ të “Kolegjit Profesional i Formimit Policor;

- Tryezat për bashkëbisedim dhe shkëmbime mendimesh me specialistët, pedagogët dhe drejtuesit e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit dhe specialistët e sektorit të zhvillimit dhe kurrikulave;
- Marrja e mendimeve të specialistëve të strukturave operuese dhe realizimi i ballafaqimeve e konsultave me ekspertët e drejtorisë së Kufirit & Migracionit, të Rendit, Sigurisë Publike e Investigimit të Krimeve;
- Administrimi e pasqyrimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre për programin.

Gjatë kontakteve të sipërcituara me grupet e interesit dhe faktorët institucionale, departamentet i kushtuan kujdes të veçantë marrjes së vlerësimeve, mendimeve, opinioneve dhe sugjerimeve të tyre, për disa nga çështjet më thelbësore si : në cilat aspekte mendohet se duhet përmirësuar puna akademike për lartësimin e profilit të punonjësit të ardhshëm të policisë të rolit bazë, për rendin dhe sigurinë dhe luftën ndaj krimit; drejtimit ku duhet të thellohet veprimtaria e arsimimit profesional për të evituar hendekun midis teorisë dhe praktikës dhe rritjen e shkallës së integritetit mes tyre; është e mjaftueshme përgatitja për t'u përballur me format e reja të kriminalitetit dhe tendencat e zhvillimeve në fushën e rendit dhe krimit; programi mësimor aktual përcjell kulturën qytetare, dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të ketë punonjësi i ardhshëm i policisë i rolit bazë të ditëve tona; përmirësimet e nevojshme që duhen bërë në programet e zhvilluara deri tani.

5. Veprimtaritë formuese që përbëjnë “Planin mësimor”.

Lista me lëndët mësimore të programit të studimit dhe konkretisht të këtij plani mësimor përbëhet nga dy grupe kryesore lëndësh: lëndë të formimit bazik apo të përgjithshëm dhe lëndë të formimit karakteristik ose profesional. Duke depërtuar në to, dallohen lëndë të profilit juridik, të profilit psikologjik e social, të profilit policor për të gjitha llojet e shërbimeve, të formimit fiziko-taktik, mjeshtrinë e përdorimit të armëve të zjarrit, etj., të cilat, jo vetëm që rrisin nivelin në realizimin e profilit kulturor, juridik e profesional të punonjësit të ardhshëm të policisë të nivelit zbatues, por rrisin edhe atë të vetë planit mësimor. Efektivisht është parashikuar që të zhvillohen:

- disiplina bazë, ose grup disiplinash formuese që lidhen me formimin e përgjithshëm;
- disiplina karakterizuese, ose grup disiplinash formuese profesionalisht të cilat lidhen me përkatësinë e programit të studimit;
- disiplina integruese, ose formuese apo grup disiplinash të ngjashme ose/dhe të përafërta me disiplinat profesionale ndërdisiplinore, (njohuri juridike, etj.;
- veprimtari për përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike, komunikuese dhe prezantuese, sikurse dhe aktivitete formuese që lidhen me praktikat profesionale apo me përgatitjen e tezës së diplomës.

6. Struktura e Planit Mësimor.

Nr	Lëndet mesimore/ (Module)	Kat.	ECTS	Lex	Sem	Prakt.	Përg. Individ /Studim	Total	Provime/ Quiz-e
1	Policimi Përgjithshëm	B	23	286	83	48	158	575	6
2	Aftësimi Policor Operacional	B	9	30			13	225	
3	Stërvitja Fizike	B							
4	Njohuri mbi armët e zjarrit/qitje	B	11	107			57	275	
5	Ndihma e Parë Mjekësore	C							

6	Teknologji e Informatikës	A							
7	Gjuhë e Huaj (Anglisht)	A							
8	Praktikë në Teren	D	17			424		424	
	Provimi përfundimtar	E	-	-	-	-	-	-	1
	Shuma e orëve/ECTS		60					1500	

6.1. Veprimtaritë formuese të planit sipas kategorive, orëve dhe moduleve.

Veprimtaritë formuese dhe lëndët apo disiplinat që përbëjnë planin mësimor, rrjedhimisht dhe programin e studimit, në tërësinë e tyre gjykohen të grupuara fillimisht sipas përkatësisë apo fushës (lëndët e formimit të përgjithshëm dhe lëndët e formimit profesional).

7. Ndarja e lëndëve sipas Veprimtarive Formuese

1. Formimi i përgjithshëm,

Lëndet mësimore:

Legjislacion policor;
Njohuri mbi Sociologjinë /Psikologjinë/Komunikimin;
Gjuhe e huaj;
Informatikë;
Njohuri juridike.

2. Formimit profesional

Lëndet mësimore

Shërbime policore;
Njohuri armë zjarri/qitje;
Taktika/teknika policore;
Perg.fizike/vetmbrojtje;
/KNP/disiplina;

3. Praktika Profesionale:

Përmbledhje

Nr	Modulet mesimore	Kat	ECTS	Lex	Se m	Te tjera	Perg. individ	Total	Provime
	Gjithsej 10		60	255	180	375	740	1500	8

7.2. Modulet e mundshme me lëndët e “Formimit të përgjithshëm”.

4. Legjislacion policor:

- Historiku i Policisë Shqiptare;
- Roli i policisë në shoqëritë demokratike;
- Parimet e policimit në demokraci;
- Misioni, statusi, parimet e veprimtarisë dhe detyrat e Policisë së Shtetit;
- Organizimi i Policisë së Shtetit;
- Mardhëniet e punës në Policinë e Shtetit;

- Detyrime dhe kufizime për punonjësit e policisë;
- Ecuria në karrierë e punonjësit të policisë;
- Kodi Etik i Policisë së Shtetit;
- Masat për ruajtjen e rendit e sigurisë publike;
- Disiplina dhe hetimi disiplinor;
- Korrupsioni në polici;
- Institucione të tjera ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë;

5. Njohuri Juridike

- Të drejtat e Njeriut;
- Sistemi demokratik dhe institucionet e tij;
- Kodi Penal i R.SH;
- Kodi i Procedurës Penale i R.SH;
- Legjislacioni mbi kundërvajtjet administrative;
- Përmbledhje e Sistemit Gjyqësor;
- Arrestimi dhe ndalimi;
- Arrestimi dhe ndalimi (të miturit);

6. Njohuri mbi Sociologjinë/Psikologjinë/Komunikimin)

- Karakteristikat e grupeve shoqërore, faktorët social që ndikojnë në kriminalitet;
- Personaliteti antisocial, çrregullime antisociale të personalitetit;
- Aftësitë Komunikuese;
- Ndërgjegjësimi mbi diversitetin;
- Çështjet të barazisë dhe mosdiskriminimit;
- Menaxhimi i stresit;
- Njohuri mbi punën në grup;
- Trajtimi i mosmarrëveshjeve;
- Intervistimi;

7. Informatikë

- Njohuri themelore për kompjuterin.Sistemi Ëindoës;
- Microsoft Office Ëord 2007;
- Microsoft Poëer Point 2007;
- Njohuri mbi faqen e D.T.I.-së;
- E-mail-ASP;
- Sistemi “TIMS”.Regjistrimi në sistem i hyrje- daljeve në pikat kufitare;
- Sistemi elektronik E-Gjoba (procesi i bllokut ,Gjobë e re);
- Sistemi “ADAM” (Krijimi i nje raporti shoqërimi);
- Menaxhimi Policor i Çështjes (Raporti i Ngjarjes);

8. Gjuhë e huaj (Anglisht)

- Being Me & Social Life;
- Meet The Family & Nearest And Dearest;
- Being A Traveller;
- On The Road & Enjoy Your Trip;
- Traveller’s Tale 8;
- Traveller’s Tale;
- It’s For You & Talk To Me;
- Being A Consumer;

- Ready To Order & Food To Go;
- Being A Foreigner & When In Romë;
- Let's Celebrate;
- Being Fashionable;
- Being A Worker & 9 To 5;
- Human Being & Under Pressure;

7.3. Modulet e lëndëve të “Formimit profesional”

1. Shërbimet policore:

a) Shërbime për ruajtjen e rendit e sigurisë publike:

- Kuptimi, roli dhe rëndësia e patrullës së përgjithshme, procedurat e patrullimit dhe mbajtja e shënimeve;
- Kontrollat;
- Menaxhimi i incidenteve. Policimi në Komunitet;
- Shoqërimi i personave. Raporti i shoqërimit;
- Shërbimi policor në aktivitete sportive, tubime, manifestime, plazhe dhe zona turistike.
- Ruajtja dhe siguri i PLSH-ve;
- Shërbimet për kontrollin e territorit;
- Procedurat e dhe teknikat e patrullimit;
- Sigurimi i objekteve;
- Mbajtja e shënimeve;
- Sigurimi dhe ruajtja e personave në ambientet e policisë;
- Shërbimet gjatë fushatave zgjedhore e ditën e votimit;
- Policimi në komunitet;
- Dhuna në familje;
- Kontrollat ndaj mallrave të rrezikshme;

b) Shërbimi i Policisë Rrugore dhe Siguria:

- Legjislacioni rrugor (Kodi Rrugor);
- Konstatimi i shkeljeve në fushën e qarkullimit, dokumentacioni;
- Mjetet teknike për verifikimin e shkeljeve, etilometri;
- Aksidentet rrugore, ushtrime praktike për to;
- Elementë të drejtimit dhe menaxhimit të trafikut;

c) Policia Kufitare dhe Migracioni:

- Misioni i Policisë Kufitare dhe Migracionit;
- Kuptimi mbi kontrollin kufitar;
- Kufijtë shtetërore të R.Shqipërisë;
- Policia Kufitare dhe Migracioni;
- Kontrolli kufitar, hyrje-daljet në kufi;
- Kontrolli kufitar, lëvizja e lirë, BE, Shengeni;
- Dokumentet e udhëtimit;

d) Njohuri për hetimi i krimit:

- Përpilimi i raportit të ngjarjes;
- Njohuri mbi personat në kërkim;
- Kuptimi mbi vendin e ngjarjes, provat dhe ruajtja e tyre;
- Zinxhiri i ruajtjes së provave materiale;

- Mbledhja e provave në vendngjarje;
- Njohjuri mbi hetimin e veprave penale kundër jetës dhe shëndetit;
- Njohjuri mbi hetimin e veprave penale kundër integritetit seksual;
- Njohjuri mbi hetimin e veprave penale kundër pronës;
- Njohjuri mbi hetimin e sulmeve fizike;
- Njohjuri mbi hetimin e veprave penale kundër vjedhjes me dhunë;
- Njohjuri mbi hetimin e veprave penale kundër vjedhjes së automjeteve;
- Njohjuri mbi hetimin e veprave penale kundër mjedisit;
- Njohjuri mbi falsifikimin e dokumenteve;
- Njohjuri mbi hetimin e veprave penale të trafikimit;
- Njohjuri mbi hetimin e veprave penale kundër narkotikeve;
- Kuptimi mbi informacionin policor;

2. Taktika dhe teknika veprimi:

- Mbijetesja e dhe siguria e oficerit;
- Përdorimi i forcës;
- Prangosja;
- Teknikat e buta dhe të ashpra të kontrollit mbi personin;
- Teknikat e përdorimit të shkopit të policies;
- Ruajtja dhe zotrimi i armës;
- Ndalimi dhe kontrolli i automjeteve;
- Ndjekja me automjet dhe në këmbë;
- Kontrolli dhe shoqërimi i të dyshuarit;
- Ndërhyrjet në incidente dhe konflikte;
- Veprimet e oficerit në tubime dhe manifestime të ndryshme;
- Teknikat dhe taktikat gjatë ndërhyrjeve në lokale;
- Pika e kontrollit dhe postblloku policor;
- Teknikat dhe konceptet bazë për kontrollin e ndërtesa;
- Hyrja dhe kontrolli i dhomave;
- Kontrolli i ndërtesave;
- Ruajtja e personave me masë sigurie në spitale dhe gjatë shoqërimit;
- Teknikat dhe procedurat e shoqërimit të personave të rrezikshëm (Eskorta e shoqërimit) dhe tifozeve;

3. Aftësimi tekniko-taktik, AZ dhe qitje:

- Legjislacioni mbi përdorimin e armëve të zjarrit;
- Përgatitja mendore (psikologjia) dhe disiplina në përdorimin e armëve të zjarrit;
- Ngjarjet në poligon, plumbat e bojës, rregullat e sigurisë me plumbat e bojës;
- Siguria me Armën dhe Terminologjia;
- Praktikë në Përdorimin e Armës;
- Forca vdekjeprurëse;
- Mirëmbajtja e armës, analiza e qitjes;
- Eksplozivat;
- Simulatori i Trajnimit me Armët e Zjarrit;
- Prezantimi, siguria, përdorimi, keqfunksionimet e automatikut AK-47;
- Përgatitje për qitje dhe qitje;

4. Përgatitje fizike dhe vetmbrojtje:

- Rrjeshtimet;

- Reniet amortizuese;
- Vrapime shpejtësie;
- Pozicioni Mbrojtës;
- Ushtrime akrobatike;
- Qëndrueshmeri;
- Njohuri mbi pozicionin bazë të luftimit;
- Vrapime qëndrueshmëri;
- Perfeksionimi i tekniës së rënieve amortizuese;
- Stërvitje me pesha;
- Njohuri mbi mbrojtjet nga goditjet me grusht;
- Lojra sportive;
- Njohuri mbi teknikat e mbrojtjes nga goditjet me shqelm;
- Perfeksionim i teknikave të luftimit ne tokë;
- Stërvitje qarkore (cirkuid);
- Stërvitje në palestër force;
- Ushtrime të lira akrobaci;
- Stërvitje për forcën e krahëve (pompa);
- Njohuri mbi teknikën e hedhjes krahësups;
- Perfeksionim i teknikës së hedhjes krahësups;
- Përgatitje për zhvillimin e forcës;
- Ushtrim force për krahët;
- Perfeksionimi i teknikave të përdorimit të prangave;
- Perfeksionim i teknikës së hedhjes krahëtrung;
- Gjimnastikë, ushtrime në paralele;
- Teknika e krahësupsit (arrestimi);
- Ushtrime në hekurin gjimnastikor;

7.4. Praktikë mësimore.

7.5. Plani mësimor sipas semestrave, etj.

Tërësia e lëndëve mësimore dhe aktiviteteve përbërëse të tyre, do të mund të realizojnë qëllimin e planit dhe objektivat formuese të vetë programit të studimeve, nëse bazohen në një plan kalendarik të studiuar dhe vendosen të renditura sipas kohës që do të zhvillohen, sipas krediteve për çdo veprimtari formuese, të ndara në leksione, seminare, punë praktike, detyra, projekte, etj., por dhe nëse ka përcaktime të qarta të ngarkesës në auditor dhe ngarkesës (studimit individual) jashtë auditorit, etj.

SEMESTRI I PARË:

1. Formimi i përgjithshëm,

Lëndet mesimore:

Legjislacion policor;
 Njohuri mbi Sociologjinë /Psikologjinë/ Komunikimin;
 Gjuhe e huaj;
 Informatike;
 Njohuri juridike;

2. Formimi profesional:

Lëndët mesimore:

Shërbime policore;

Njohuri armë zjarri/qitje;
Taktika/teknika policore;
Përgatitje fizike/vetmbrojtje;
KNP/disiplina;

SEMESTRI I DYTË:

1. Praktika Profesionale (Trajnimi në Terren).

7.6. Lëndët që jepen provim:

1. Legjislacioni policor + Njohuri juridike;
2. Njohuri mbi Sociologjinë/Psikologjinë/Komunikimin;
3. Gjuhë e huaj (anglisht);
4. Informatikë;
5. Shërbime policore;
6. Njohuri armë zjarri/qitje;
7. Taktika e teknika veprimi policor;
8. Përgatitje fizike/vetmbrojtje;

8. Vështrim analitik i raporteve teori – praktikë në “Planin mësimor”.

8.1. **Përkatësia e lëndëve.** Një vështrim i përgjithshëm analitik e krahasues mbi planin mësimor, për përkatësinë e lëndëve të karakterit formues, për raportet teori-praktikë, ndarjen e orëve dhe krediteve ECTS, evidenton se:

- në grupin e lëndëve dhe moduleve profesionale, të kategorisë “B” janë 4 lëndë dhe kanë 36 kredite ECTS, të cilat zënë rreth **58.06 %** të orëve të Programit (900 nga 1550 orë gjithsej);
- pjesa tjetër, e lëndëve i përkasin “Formimit të përgjithshëm”, të cilat kanë 14 kredite ECTS, dhe zënë rreth **22.58 %** të orëve (350 nga 1550 orë gjithsej).
- praktika profesionale që zhvillohet në fund të semestrit të dytë, ka 10 kredite ECTS, (16.66 % të totalit të krediteve) zë rreth 19.35 % të totalit orëve mësiore (300 orë nga 1550 orë gjithsej).

8.2. **Raporti teori-praktikë (orë leksioni me orë seminari, punë praktike, etj.)** Studimi i raporteve midis orëve të lëndëve të “Formimit profesional” dhe orëve të lëndëve të “Formimit të përgjithshëm” evidentohet se:

a. Formimit profesional i përkasin:

- 83.78% e orëve të seminareve dhe punës praktike,
- 52.94% e orëve të leksioneve,
- 68.18% i orëve të studimit individual.

b. Formimit të përgjithshëm i përkasin:

- 16.21% e orëve të seminareve dhe punës praktike,
- 47.05% e orëve të leksioneve i përkasin disiplinave profesionale,
- 31.81% i orëve të studimit individual.

Po ashtu, nga vështrimi i tërësisë së veprimtarive dhe disiplinave formuese të planit mësimor, veçanërisht për raportin midis mësimave apo shpjegimeve teorike (leksioneve) dhe seminareve, punës praktike dhe kontrollit të dijeve në auditor, përftohet konkretisht kjo ndarje:

- nga 1500 orë mësimi në total, rreth 810 orë, afërsisht 52.25% e totalit, janë orë mësimi në auditor (leksione, seminare, punë praktike, etj.).

- nga orët e mësimin në auditor, 810 orë, ose rreth 16.45% janë leksione dhe rreth 555 orë, ose rreth 68.51% janë seminare e punë praktike;
- brenda zërit “mësime praktike”, seminarët janë 165 orë dhe zënë rreth 29.72% të tyre dhe orët e punëve apo mësime praktike janë 390 ose 70.27%;
- pjesa tjetër, rreth 740 orë, ose 47.74% e gjithë orëve të studimeve, është studim individual i pavarur dhe ka të bëjë kryesisht me studimin e literaturës së rekomanduar, punim relacionesh, detyrash apo projektsh, përgatitje provimesh, etj. Sqarojmë se, në këtë grup orësh, përfshihen dhe veprimtari të tilla si praktika profesionale apo stazhi pranë strukturave vendore e rajonale të policisë dhe përgatitja e tezës së diplomës.

8.3. *Impakti pozitiv në formimin e studentëve.* Nga ballafaqimi i shifrave të sipërpërmendura, raportet në përqindje 52.25 % (studim në auditor) me 47.75%, (studim individual), i gjejmë me vend e të rregullt. Shkuarja, pothuajse deri të barazimi i orëve të mësimin në auditor dhe studimit të pavarur apo individual, do të bëjë që, tek studenti të kultivohet e rritet përgjegjshmëria personale, ndjenja për të punuar në mënyrë të pavarur, për t'u përshtatur me situatat dhe për të zbatuar njohuritë në praktikë. Sikurse do të krijohen e zhvillohen tek ai aftësitë vepruese, do të rritet iniciativa, aftësitë e komunikimit e bashkëpunimit, të vlerësimit të zgjidhjeve alternative dhe respektimit të mendimit ndryshe, etj.

9. Standardet e personelit akademik.

Personeli akademik i Kolegjit Profesional i Formimit Policor, i cili do të realizojë programin e studimeve, të profilit “Patrullë e Përgjithshme” për rendin dhe sigurinë publike me studentët e kolegjit, përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës mësimor dhe personeli administrativ. Detyrat dhe të drejtat e tyre përcaktohen në legjislacionin për Arsimin e Lartë dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij, në legjislacionin për Policinë e Shtetit, në statutin e Akademisë së Sigurisë dhe në rregulloret e brendshme. Sikurse në të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë, ata kategorizohen sipas rolit dhe veprimtarisë që kryejnë në procesin mësimor.

Për rekrutimin e personelit akademik të Kolegjit Profesional i Formimit Policor, kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të cilat kushtëzohen nga kriteret e përmendura më sipër. Si kategori e veçantë, personeli akademik i departamenteve përbërës të Kolegjit Profesional i Formimit Policor përveç kërkesave të përgjithshme, kandidati duhet të plotësojë disa kriteret e veçanta të hartuara e miratuara nga Senati Akademik. Ndër to janë:

- të ketë mbaruar studimet me kohë të plotë në Akademinë e Policisë;
- të ketë kryer minimalisht studimet e nivelit “Master” për lëndët që do të japë në auditor;
- për personelin akademik civil duhet të ketë minimalisht studimet e nivelit “Master” për lëndët që do të japë në auditor;
- të ketë notën mesatare mbi 8 të lëndëve që do të jetë pedagog;
- të ketë mbi 10 vjet shërbim policor dhe të ketë fituar gradën Komisar/Kryekomisar/Drejtnes.

Përbëjnë avantazh:

- përvoja si pedagog në sistemin arsimor të policisë;
- të ketë aftësi të mira komunikuese dhe motivim për të punuar në grup, etj.

Personeli akademik duhet të kryejë veprimtari të mësimdhënies, shërbime për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të institucionit, konsultim dhe këshillim për studentët, si dhe detyra administrative. Raportet ndërmjet tyre dhe veprimtarive të ndryshme përcaktohen në rregulloret e departamenteve, në rregulloren e Kolegjit Profesional i Formimit Policor, në statut dhe janë pjesë e kontratave të punës mes palëve.

* *

